

EFIÇIENCA E ENERGJISË

FRONTI I PARË DREJTË TRANZICIONIT



HYRJE


Më 5 mars, në Ditën Ndërkombëtare të Eficiencës së Energjisë, debati për energjinë zakonisht përqendrohet te prodhimi i energjisë, investimet në kapacitete të reja apo siguria e furnizimit. Megjithatë, një nga instrumentet më efektive për sigurinë energjetike, për uljen e kostove dhe për përshpejtimin e tranzicionit energjetik mbetet shpesh i nënvlerësuar: eficientia e energjisë. Në realitet, eficientia e energjisë nuk duhet të trajtohet vetëm si një masë kursimi, por si burim energjie në vetvete.

Në shumë vende, investimet në eficientë trajtohen në planifikimin energjetik njësoj sikur të ishin kapacitete të reja prodhuese, sepse energjia që nuk konsumohet është shpesh energjia më e lirë, më e pastër dhe më e shpejtë për t'u siguruar. Për Kosovën, ku kërkesa për energji është në rritje dhe sistemi energjetik përballet me presione të mëdha investuese, eficientia e energjisë duhet të vendoset në frontin e parë të tranzicionit energjetik.

Pse eficientia është kritike për Kosovën

Kosova mbetet ndër ekonomitë me intensitet të lartë energjetik në rajon dhe në Evropë. Intensiteti energjetik – që mat sasinë e energjisë së përdorur për të prodhuar një njësi të prodhimit ekonomik – është dukshëm më i lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian. Kjo tregon se ekonomia dhe sektori i ndërtesave konsumojnë më shumë energji sesa do të ishte e nevojshme për të njëjtin nivel aktiviteti ekonomik.


Krahasimi i Intensitetit Energjetik: Kosova vs BE (2020)



Ky potencial i madh për kursim energjie nënkupton se investimet në eficientë mund të prodhojnë rezultate të menjëhershme dhe strukturore, duke ulur kërkesën për energji elektrike, duke zvogëluar importet dhe duke reduktuar presionin mbi sistemin energjetik.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031 e njih qartë këtë rol dhe e vendos eficientën e energjisë si një nga shtyllat kryesore të tranzicionit energjetik të vendit. Strategjia parasheh përmirësime të konsiderueshme në eficientën e energjisë në sektorët e ndërtesave, industrisë dhe transportit, si dhe rritjen e investimeve në modernizimin e stokut ekzistues të ndërtesave.

Roli i Fondit të Efiçencës së Energjisë



Një nga institucionet më të rëndësishme për zbatimin e politikave të efiçencës së energjisë në Kosovë është Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE). Fondi është krijuar për të mobilizuar dhe menaxhuar financime për projekte të efiçencës së energjisë, veçanërisht në sektorin publik dhe në ndërtesa. Përmes programeve të tij, Fondi ka financuar ndërhyrje në ndërtesa publike, duke përfshirë izolimin termik, modernizimin e sistemeve të ngrohjes dhe përmirësimin e performancës energjetike të objekteve.

Megjithatë, potenciali i Fondit është shumë më i madh se sa niveli aktual i investimeve. Nëse efiçenca e energjisë trajtohet si kapacitet i ri energjetik, atëherë programet e efiçencës duhet të jenë në shkallë shumë më të madhe – me investime që arrijnë qindra miliona euro në vitet e ardhshme.

Kjo kërkon:

rritje të kapitalizimit të Fondit;

zgjerim të programeve për sektorin rezidencial dhe privat;

mekanizma të rinj financiarë që mundësojnë pjesëmarrjen e sektorit financiar dhe investimeve private.

Nevoja për planifikim energjetik të bazuar në të dhëna

Një nga sfidat kryesore të politikave të efijencës në Kosovë është mungesa e të dhënave të detajuara dhe transparente për konsumin energjetik.

Për të planifikuar ndërhyrje efektive, është e domosdoshme të krijohet një pasqyrë e plotë e rrjedhave energjetike në vend, duke përfshirë konsumin sipas sektorëve, ndërtesave dhe teknologjive.

Në këtë drejtim, zbatimi i plotë i Ligjit për Performancën Energjetike në Ndërtesa është një hap kritik.


Ky ligj mundëson krijimin e:

- ☒ një stoku kombëtar të ndërtesave,
- ☒ të dhënave të detajuara për performancën energjetike,
- ☒ dhe identifikimin e ndërtesave me potencialin më të madh për ndërhyrje.

Këto të dhëna janë të domosdoshme për të projektuar programe të targetuara dhe për të siguruar që investimet publike dhe private të drejtohen aty ku ndikimi është më i madh.



Zbatimi i plotë i Ligjit për Performancën Energjetike në Ndërtesa





Instrumentet fiskale dhe çështja e të ardhurave të dedikuara

Politikat fiskale mund të luajnë rol të rëndësishëm në financimin e efijencës së energjisë. Në shumë vende, instrumente si taksat mjesore ose tarifat mbi produkte joeficiente përdoren për të financuar programe të efijencës.

Në Kosovë, disa mekanizma fiskalë tashmë ekzistojnë, si p.sh.:

- ☒ taksa për qeset plastike,
- ☒ taksat rrugore,
- ☒ apo potencialisht taksa mbi pajisje energjetike joeficiente.

Megjithatë, një problem strukturor është se këto të ardhura nuk trajtohen si të ardhura të dedikuara për politika specifike, por hyjnë në buxhetin e përgjithshëm dhe rishpërndahen sipas prioriteteve buxhetore.

Nëse Kosova synon të krijojë një program serioz kombëtar për efijencën e energjisë, është e nevojshme që një pjesë e këtyre të ardhurave të dedikohen drejtpërdrejt për financimin e programeve të efijencës.




Programi i Projektligjeve për vitet 2026–2028 ofron një mundësi për të adresuar këtë çështje përmes rishikimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, duke mundësuar krijimin e mekanizmave për financim të dedikuar të politikave të tranzicionit energjetik.

Rishikimi i kuadrit ligjor për efijencën

Në të njëjtën kohë, edhe Ligji për Efijencën e Energjisë duhet të rishikohet për të reflektuar zhvillimet e fundit në politikat energjetike dhe klimatike të Evropës dhe për të forcuar mekanizmat institucionalë për zbatimin e politikave të efijencës.



Një rishikim i tillë duhet të adresojë:

-  **forcimin e rolit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikave të efijencës;**
-  **integrimin më të mirë të politikave të efijencës në planifikimin energjetik dhe klimatik;**
-  **krijimin e mekanizmave më të fortë për monitorimin dhe raportimin e progresit.**

Rekomandime politike

Për të vendosur eficiencën e energjisë në qendër të tranzicionit energjetik, Kosova duhet të ndërmarrë disa hapa strategjikë:

1. Të trajtojë eficiencën e energjisë si kapacitet energjetik, duke e integruar atë në planifikimin energjetik në të njëjtin nivel me investimet në kapacitete të reja prodhuese.
2. Të rrisë ndjeshëm investimet publike në eficiencën e energjisë, përmes një programi kombëtar që mobilizon qindra miliona euro në dekadën e ardhshme.
3. Të forcojë dhe kapitalizojë më tej Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, duke zgjeruar programet e tij edhe për sektorin rezidencial dhe për bizneset.
4. Të zbatojë plotësisht Ligjin për Performancën Energjetike në Ndërtesa, për të krijuar një stok kombëtar të ndërtesave dhe një bazë të plotë të të dhënave për konsumin energjetik.
5. Të krijojë mekanizma për financim të dedikuar të politikave të eficiencës, duke lidhur instrumentet fiskale mjedisore me financimin e programeve të tranzicionit energjetik.
6. Të rishikojë Ligjin për Eficiencën e Energjisë, në përputhje me zhvillimet e fundit të acquis të Bashkimit Evropian dhe me objektivat e Strategjisë së Energjisë 2022–2031.